



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:203325

Datë: 10.06.2024

Numri i dokumentit: 05802119

C.nr. 534/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Shemsedin Haxhiaj në çështjen juridike kontestimore, të paditësit S.L nga P...., të cilin e përfaqëson SH.M-F avokate nga Istogu, kundër të paditurit A.O.LL I... P...., të cilin e përfaqëson Z.B avokat nga Istogu, nga baza juridike: pengim posedimi, në prezencën e paditësit dhe të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, në seancën e shqyrtimit kryesor, të datës 24.05.2024, bie këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesëpadia e paditësit S.L nga P...., me të cilën ka kërkuar që të VËRTETOHET se i padituri A.LL nga I... P.... ka penguar paditësin S.L në posedimin e fundit faktik, ku paditësi e shfrytëzon atë pronë dhe qëllimi ka qenë me ja vendos kufijtë ngastrës së tij, me ngastrat fqinjë në atë mënyrë që me datë 10.09.2022, i padituri e ka penguar paditësin në shfrytëzimin e lirë të pronës së tij duke e penguar, duke ja ndaluar matjen e pronës së tij pikërisht vendi ku ka ndodhë pengim posedimi shtrihet në ngastrën kadastrale ./ përgjatë gjithë anës perëndimore të kësaj parcele me gjatësi prej 53.07m dhe pjesës së gjatësisë anës jug-perëndimore të parcelës ./, me gjatësi prej 35.23m ku në këtë pjesë i padituri nuk e ka lejuar paditësin edhe duke e kërcënuar se nuk do të matet në atë mënyrë siç e ka trashëguar paditësi por sipas mënyrës së tij, ai dhe të Urdhërohet i padituri që ti lejojë paditësit shfrytëzimin e të drejtës së tij për shfrytëzimin dhe disponimin në çfarëdo forme me pronën e trashëguar si dhe vendosjen e kufinjëve si më lartë dhe i njëjti të përmbahet në të ardhmen nga pengimi i posedimit dhe shfrytëzimit të kësaj prone nën kërcënim të pasojave ligjore.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.**

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarës së tij, me padi si dhe në precizimin e saj me parashtrësën e datës 10.10.2023, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare, ka kërkuar që të vërtetohet se i padituri A.LL nga I... P.... ka penguar paditësin S.L në posedimin e fundit faktik, ku paditësi e shfrytëzon atë pronë dhe qëllimi ka qenë me ja vendos kufijtë ngastrës së

tij, me ngastrat fqinjë në atë mënyrë që me datë 10.09.2022, i padituri e ka penguar paditësit në shfrytëzimin e lirë të pronës së tij duke e penguar, duke ja ndaluar matjen e pronës së tij pikërisht vendi ku ka ndodhë pengim posedimi shtrihet në ngastrën kadastrale ./.. përgjatë gjithë anës perëndimore të kësaj parcele me gjatësi prej 53.07m dhe pjesës së gjatësisë anës jug-perëndimore të parcelës ./., me gjatësi prej 35.23m ku në këtë pjesë i padituri nuk e ka lejuar paditësin edhe duke e kërcënuar se nuk do të matet në atë mënyrë siç e ka trashëguar paditësi por sipas mënyrës së tij.

Në fjalën përfundimtare e autorizuar e paditësit, ka deklaruar se nga provat e administruara gjatë këtij shqyrtimi gjyqësorë, duke ju referuar edhe pengesave të gjeodetit si dhe konstatimeve të tij se ka dal në vend ngjarje por nuk ka mundur të mat tokën për shkak të mosmarrëveshjeve, vlen të theksohet se edhe vet deklarimet e të autorizuarit të paditurit në seancën e datës 25.01.2023, e kishte deklaruar se i kishte prerë disa arra dhe mengjen me çka e vërteton se posedues i fundit faktik është paditësi, ndërsa sa i përket dëshmitarit A.M i njëjti nuk ka qenë në dijeni se kush e posedon në dy vitet e fundit andaj vlen të theksohet se i njëjti e ka pronën ngjitur me pronën kontestuese, ku edhe kërkojmë që deklaratës së të njëjtit të mos i falet besimi. Pranë kësaj gjykate janë dëgjuar edhe vet ndërgjyqësit në cilësi të palëve, ku vet i padituri kishte pranuar që se punon pjesën kontestuese me çka edhe vërehet se poseduesi i fundit faktik është paditësi. Meqenëse kemi të bëjmë me çështjen e pengim posedimit ku duhet të përmbushen kushtet e që janë posedues i fundit faktik, pengim në shfrytëzim të lirë nga vet i padituri pasi që paditësi kishte të drejtën që në pronën e tij të qeveris në çfarëdo forme pa asnjë pengesë nga askush. Andaj kërkojmë nga gjykata që padinë e paditësit ta aprovojë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet procedurale i kërkojmë dhe atë për 10 seanca për secilën nga 150 euro, për padinë në vlerë prej 104 euro, për precizimin e kërkesëpadisë në vlerë prej 104 euro, për taksën gjyqësore 50 euro, për ekspertizën e gjeodezisë shumë prej 150 euro, e në vlerë totale 2.043,00 euro.

I padituri përmes të autorizuarit të tij, me anë të përgjigjes në padi, gjatë shqyrtimit kryesorë si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se paditësi nuk ka arritur që të dëshmojë se i padituri A.LL nga I... P.... ka ushtruar pendim posedimin sa i përket ngastrës kadastrale me numër ./.. ./.. dhe ./.. gjëja se me datën 10.10.2022 paditësi duke pretenduar të bëjë identifikimin e ngastrave të cekura, e duke pretenduar se i padituri i ka penguar në identifikimin e tyre, është e pa vërtet ngase vet gjeodeti Z.I dëshmon në cilësi të dëshmitarit se ai nuk ishte i përgatitur për identifikimin por vetëm për të bërë incizimin e terrenit e më pastaj të dal në vendin e ngjarjes, e cila nuk u realizua pasi që paditësi S.L kishte heq dorë nga një veprim i tillë. I padituri nuk kishte marrë asnjë veprim lidhur me pengimin e posedimit të pronës tani kontestuese të cilën e kishte punuar babagjyshi i tij dhe pastaj i padituri personalisht me shumë se 5 vite e gjegjësisht gjer në vitin 2020 me qera. Paditësi pretendon se pengim posedimi është bërë në pjesën nga hyrja, ana perëndimore gjegjësisht se shtalla e bagëtisë është në pronën e tij, mirëpo me nxjerrjen e provave gjeodezike nga ana e ekspertit gjeodet konstatohet se aty pari nuk ka pas mundësi uzurpimi pasi që përkufizimi del se është në kufi me megjën e të paditurit, për çudi më pastaj pretendon se pengim posedimi ka ndodh mu në anën perëndimore por më poshtë tek arra, pasi që edhe ajo është vërtetuar se nuk qëndron vazhdon pretendimit i paditësit se pengimi ndodhi tek shtylla elektrike po ashtu në anën perëndimore të ngastrës, mirëpo edhe pas rishikimit te ekspertit

gjeodet me raportin plotësues nuk mund të vërtetohej se pati pengim posedimi ngase megjia ekzistuese e vitit 2012 është totalisht në përputhshmëri me atë të marrjes së tanishme ku të padituri fare nuk i kujtohet se kishte marrë ndonjë veprim lidhur me pengim posedimi ngase dy vitet e fundit i njëjti ia ka ndërprerë shfrytëzimin e pronës me qera dhe se prona ka mbetur e pa punuar pasi që pronari asnjëherë më parë nuk e kishte punuar e as që din ta punojë, pasi që në pyetjen e gjykatës se çfarë ishte mbjellur i njëjti kishte deklaruar jongje që nuk është e vërtetë pasi ishte djerrinë që dy vite. Po ashtu edhe nga deklaratimet e dëshmitarëve vërtetohet se nuk kemi patur pengim posedimi ngase aty pari ishte megjia e formuar qysh në vitin 2012 e pa dëmtuar ku shihet qartë se nuk ka pengim posedim, nga eksperti gjeodet i padituri nuk ka marrë asnjë veprim i cili mund të trajtohet si pengim posedim. Është fakt i pa kontestueshëm, që nuk kemi të bëjmë me pengim posedim nga deklaratat e dëshmitarëve, raportet e ekspertit gjeodet dhe me anë të provave që gjenden në shkresat e lëndës, ku vërtetojnë se nuk kemi të bëjmë me pengim posedim as te shtalla, as te arra, te shtylla elektrike dhe as te bunari me çka i propozojë gjykatë se ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar.

Gjykata në këtë çështje juridiko - kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve, ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat: Certifikatën pronësore të datës 23.11.2012 si dhe kopjen e planit të datës 01.08.2012, kontratën mbi faljen e pasurisë së datës 29.11.2002 të lidhur në mes Z.LL-P si falëdhënëse dhe B.LL si falëmarres, ngastrën e cila është objekt i kontratës të cekur si në kontratë të vërtetuar pranë ish Gjykatës Komunale në Istog me datës 29.11.2002 me numër Vr.nr. 1252/02 fletëpagesat në emër të ekspertit gjeodet Z.I të bërë nga paditësi S.L, raportin e ekspertit gjeodet GJ.M të datës 19.04.2023 së bashku me certifikatën pronësore, orto-fotot, kopjen e planit si dhe fotot e realizuara në teren, plotësimi e raportit të ekspertit gjeodet të datës 17.07.2023 së bashku me skicën e matjes dhe fotot e realizuara në teren. Disa sms të transkriptuara në mes Q.I si blerës potencial dhe këtu paditësit, dëgjimi i palëve në cilësi të palëve, dëgjimi i dëshmitarëve Z.I, N.D që të dy nga Istogu, A.M nga fshati I.... P....., dhe Z.P e lindur LL., nga P.....

Për të vërtetuar gjendjen faktike gjykata në cilësi të provës materiale ka nxjerrë ekspertizën e ekspertit gjeodet GJ.M të datës 19.04.2023, sqarimet e dhëna në seancën e datës 30.05.2024, si dhe plotësimin e raportit të datës 17.07.2023, i cili e ka bërë identifikimin, përshkrimin e njërive kadastrale, nr./., ./.-0, ./ dhe matjen e pjesës ku pretendohet të jetë kryer akti i pengim posedimit. Parcelat kadastrale numër ./., ./.-0, ./ në regjistrat kadastral evidentohen në pronësi të Z.S.P-LL. 1/1 në ZK. Istog. Parcela kadastrale me numër të njësisë ./ me sipërfaqe të tërësishme 12770m², shtrihet/ndodhet në ZK. Istog, vendi i quajtur "I.... P.....", me kulturë arë e klasës 1, parcela kadastrale me numër të njësisë ./.-0 me sipërfaqe të tërësishme prej 630m², shtrihet/ndodhet në ZK Istog, vend i quajtur: "I.... P.....", me kulturë pemishte e klasës 3 dhe parcela kadastrale me numër të njësisë ./ me sipërfaqe të tërësishme 970m², shtrihet/ndodhet në ZK. Istog, vend i quajtur "I.... P.....", me kulturë shtëpi, oborr dhe arrë e klasës 1. Ky kompleks i parcelave (i paraqitur në skicë të matjes me linjë ngjyrë të zezë të trash dhe të rrethuara me pika detale) shtrihet buzë rrugës publike I...-D.... "... " dhe kufizohet me këto parcela fqinje: në anën Perëndimore në drejtim të shtrirjes Jug kah Veriu, përgjatë tërë gjatësisë së parcelës kufizohet me parcelën kadastrale ./ e cila evidentohet në pronësi të M.LL me gjatësi të tërësishme prej 299.16 m nga pika detalit 1 deri në pikën numër 12, përgjatë pikave thyerëse numër 14, 13. Në

teren nga kjo anë ka një pjesë rrethojë me tela rrjetë dhe shtylla metalike ndërsa pjesa tjetër mëgje natyrore pa kufij të fortë faktik. Në anën Veriore, në drejtim të shtrirjes Perëndim kah lindja, përgjatë tërë gjatësisë së parcelës kufizohet me parcelat kadastrale ./ në pronësi të S.A ./ në pronësi të H.A ./ në pronësi të O.A ./ në pronësi të R.A ./ në pronësi të H.A ./ në pronësi të O.A ./ në pronësi të R.A ./ në pronësi të H.A.1 dhe ./ në pronësi të B.A, me gjatësi të tërësishme prej 143.25m, nga pika detalit 1 deri në pikën numër 2, ku përgjatë kësaj gjatësie në teren ka mëgje natyrore prej drunjëve dhe shkurreve të ndryshme, një pjesë e saj edhe rrethoja me tela xhemborë dhe hunjë druri. Në anën Veri-Lindore, përgjatë kësaj pjese të gjatësisë së parcelës kufizohet me parcelën kadastrale ./, e cila evidentohet në pronësi të P.Sh, varrezat me gjatësi prej 55.92m, nga pika e detalit numër 2 deri në pikën numër 3, ku përgjatë kësaj gjatësie në teren ka mëgje natyrore prej drunjve dhe shkurreve të ndryshme. Në anë Lindore, përgjatë tërë gjatësisë së parcelës kufizohet me parcelat kadastrale ./ në pronësi të I.M me gjatësi 42.82m nga pika detale numër 3 deri në pikën numër 4, ./ në pronësi të M.M me gjatësi prej 50.24m nga pika detale numër 4 deri në pikën numër 5 me ./ në bashkëpronësi të A.M, N.M, B.M, B.M dhe N.M.1 me gjatësi të tërësishme prej 98.80m nga pika detale numër 5 deri në pikën numër 11, përgjatë pikave thyerëse numër 6, 7, 8, 9, 10 ku përgjatë komplet kësaj ane ka mëgje natyrore prej drunjëve dhe shkurreve të ndryshme. Në anën Jugore përgjatë kësaj pjese të gjatësisë së parcelës kufizohet me parcelën kadastrale ./, e cila evidentohet në pronësi të P.SH, Rrugët publike me gjatësi prej 16.57m, nga pika e detalit numër 11 deri në pikën numër 12, ku përgjatë kësaj gjatësie në teren gjendet asfalti i rrugës publike I... – D... “...”. Pas Identifikimit kadastral të parcelave, gjyqtari i lëndës më urdhëroi për të bërë matjen fushore të pjesës së parcelës ku pretendohet të jetë kryer Akti i Pengim Posedimit, sipas pretendimeve të palës paditëse. Nga këto matje konstatohet se: Pjesa ku pretendohet të jetë kryer akti i Pengim posedimit gjendet përgjatë gjithë anës Perëndimore të parcelës ./ dhe përgjatë pjesës së gjatësisë së anës Jug-Perëndimore të parcelës ./, e që është konstatimi i pozicionit të rrethojës me tela rrjetë dhe shtylla metalike dhe pasqyrimin të rrugës hyrëse në raport me gjendjen kadastrale-kufirit kadastral të parcelave që janë objekt shqyrtimi i kërkesës me parcelën fqinje ./ (të cilën e shfrytëzon i padituri) konstatohet se: Rrethoja me tela është komplet e vendosur në kuadër të kufirit të brendshëm të parcelës të të paditurit dhe atë duke filluar në anën Veriore nga pika fillestare (shtyllë elektrike bandera) gjendet në pozicion prej 0.0m në raport me gjendjen kadastrale të parcelës dhe në gjatësi prej 35.23m nga pika detale numër 1 deri në pikën detale numër 2. Në pikën detale numër 2 gjendet shtylla e rrethojës (kthesë) e cila është e vendosur në kuadër të parcelës ./ në distancë prej 0.38m nga kufiri kadastral me parcelën fqinje ./ dhe ./ (me pikën detale numër 3). Nga pika detale numër 2 vazhdon rrethoja me tela rrjetë dhe shtylla metalike deri në pikën numër 4 me gjatësi 53.07m, e cila ndodhet në distancë prej 0.48m nga kufiri kadastral me parcelën ./ (me pikën detale numër 5). Nga pika detale numër 4 deri në pikën numër 13, përgjatë pikave thyerëse numër 6,8, 9, 11 është bërë matja e pasqyrimin (gjurmëve) të rrugës hyrëse për në parcelën ./ e cila në raport me gjendjen kadastrale është një pjesë në kuadër të parcelës ./, saktësisht prej pikës detale numër 4 deri në pikën numër 8, përgjatë pikës thyerëse numër 6 me gjatësi prej 8.41m. Nga pika detale numër 4 deri në pikën numër 5 në distancë prej 0.48 m, nga pika detale numër 6 deri në pikën numër 7, në distancë prej 0.80m, ndërsa në pikën detale numër 8 në distancë 0.0m. Nga pika detale numër 8 deri në pikën detale numër 13, përgjatë pikave thyerëse nr.9,11 m me gjatësi të tërësishme prej 13.04m, pasqyrimi i rrugës hyrëse është në kuadër të parcelës fqinje, në pikën detale numër 9 në distancë prej 0.75m (nga pika detale numër 10), në pikën numër 11 në distancë

prej 0.37m, (nga pika detale numër 12) dhe në pikën detale numër 13 në distancë prej 1.50m (nga pika detale numër 14). Rrethojën prej telave rrjetë sipas deklaramit të palëve ndërgjyqëse e ka vendosur i padituri i cili është posedues / shfrytëzues i parcelës ./.. Parcelat që janë objekt shqyrtimi kanë shfrytëzim aktual si tokë bujqësore arë, një pjesë tjetër pemishte e në posedim faktik/pronar paditësi. Duke shtuar se në teren parcelat kanë ndarje faktike, ngastra numër ./.. e ka kufirin faktik të fortë në teren prej pikës 2 deri te pika 1 me gjatësi 35.23m, në skicën numër 2, sepse nga skica numër 1 në drejtim të Veri-perëndimit nuk ka pasur kufij faktik. Ngastra në aspektin kadastral ka formë të trekëndëshit.

Në raportin plotësues të datës 17.07.2023 ka shtuar se meqenëse nga seanca paraprake është kërkuar nga unë që të bëjë plotësimin e ekspertizës gjeodezike me matje shtesë dhe konstatimin e të njëjtave në aspektin e sipërfaqeve ashtu edhe në atë dimensional të gjendjes faktike në teren në raport me gjendjen kadastrale sipas pretendimeve të palës paditëse dhe palës së paditur në pozicionet S1, S2, S3 dhe S4. (Referencë skica e matjes numër 1-plotësim ekspertize). Pjesa ku pretendohet të jetë kryer akti i Pengim Posedimit, gjendet përgjatë gjithë anës Perëndimore të parcelës ./.. dhe përgjatë pjesës së gjatësisë së anës Jug-Perëndimore të parcelës ./.. (tek Arra). Nga këto matje konstatoj se: Në pozicionin S1, nga pika detale numër 21 deri në pikën 1 (shtyllë elektrike-bandera) me gjatësi prej 21.09m, nuk ka kufij të fortë faktik, raporti me gjendjen kadastrale është 0.71m nga pika detale numër 21 deri në pikën numër 20 në drejtim të perëndimit. Kjo ka sipërfaqe prej 7m². Gjithashtu është bërë edhe matja e pusit të ujit (bunarit) i cili gjendet brenda kufirit kadastral të parcelës ./.. Në pozicionin S2, sipërfaqja e gjendjes faktike-pasqyrimi i rrugës hyrëse në raport me gjendjen kadastrale të parcelave ka sipërfaqe prej 25m², e cila paraqet poligonin me pika detale numër 1, 2, 4, 5, 3 që është pjesë e kufirit të brendshëm kadastral të parcelës ./.. Në aspektin dimensional është dhënë në raportin e datës 07.04.2023. Në pozicionin S3, sipërfaqja e gjendjes faktike-pasqyrimi i rrugës hyrëse në raport me gjendjen kadastrale të parcelave ka sipërfaqe prej 4m², e cila paraqet poligonin me pika detale numër 4, 6, 8, 7, 5, që është pjesë e kufirit të brendshëm kadastral të parcelës ./.. Në aspektin dimensional është dhënë në raportin e datës 07.04.2023. Në pozicionin S4, sipërfaqja e gjendjes faktike – pasqyrimi i rrugës hyrëse në raport me gjendjen kadastrale të parcelave ka sipërfaqe prej 6m², e cila paraqet poligonin me pika detale numër 8, 9, 11, 13, 14, 12, 10 që është pjesë e kufirit të brendshëm kadastral të parcelës ./.. Në aspektin dimensional është dhënë në raportin e datës 07.04.2023.

Me qëllim të vërtetimit sa me të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor ka bërë edhe procedimin e palëve ndërgjyqëse në cilësi të palëve si dhe ka bërë dëgjimin e dëshmitarëve Z.I, N.D dhe A.M.

Paditësi S.L i cili ka deklaruar: pronën e punoj gjithmonë, shkoi marr punëtorë çdo vit, krastit dhe të gjitha punët çka duhet për tokë. Që 4-5 vite kam pengesa në punimin e kësaj toke. Kam pengesë nga zotëria këtu i padituri. Me datën 10.09.2022 kam dal me kadastër, për të dytën herë të njëjtit persona, herën e parë kanë kundërshtuar me dal, sepse A. ju ka caktuar pikat ka me dal dhe ata nuk kanë dashur ashtu. Atë ditë në vend se me ma qit pronën në emrin tim kadastra ja ka qit këtij në emër të vet. Dhe me këtë datë kam shkuar edhe njëherë mi qit pikat, kam dal me Z. dhe me ty (avokatin), prezent ka qenë edhe A.. Atë ditë kemi shkuar deri tek shtalla, deri te

përfundimi i shtallës. A. na ndaloj tha që nuk bën me mat. Këtë pronë kam dashtë me shit por na ka kërcënuar A. dhe nuk kam mundur ta shes, dhe na ka penguar në shfrytëzimin e kësaj prone. Rastin e kam të hapur edhe në polici. Migjallarët e tij i kam në mëgje dhe ju kam treguar se du me nda tokën me shit pronën, dhe më kanë thënë se ti mund të bësh çka të duash se është pronë e jotja. Në vitin 2022 nuk ka qenë e mbjelle me ndonjë kulturë bujqësore, që 5 vite e ka punuar herë një vit e herë jo, herën e fundit i kam thënë që mos ta punojë më tokën. Gjatë vitit 2022 kam qenë në posedim faktik. Në ditën kur ka qenë gjeodeti në teren më ka dhënë informata lidhur me pikat se ku duhet të jenë në terren. A. është revoltuar pasi që ky ka thënë tjera pika, ku të vendohet megja, dhe e kam një video incizim ku ka treguar ky se ku duhet vendosur pikat. Pronën unë e punojë gjithë, e kam mbjellur me Terrfojë-jonxhe, dy vitet e fundit nuk ka qenë e punuar, pasi që jam në gjykatë e gjersa të vendos gjykata. Mua më ka penguar A. në gjithçka, deri sa të vendosen gurët në hyrje të pronës tënde unë e konsiderojë se me gjithçka. Në rastin konkret eksperti Z.I ka bërë zbulimin e pikave, i ka qit pika në tokën time. Pengesa është bërë prej fillimit të shtallës e deri në përfundimin e tokës që i bije deri në fund. Pasi që janë vende në dispozicion, skicat e terrenit të punuara nga eksperti gjeodet, i njëjti përshkruan pjesën ku ka qëndruar me datën qëndruar me datë 10.09.2022 së bashku me ekspertin Z.I, të autorizuarën e tij në pjesën e fundit të pozllamit duke penguar që të bëhet çfarëdo matje, caktimi i pikave kufitare në mes të dy palujtshmërive, pjesa prej shtyllës elektrike e cila është e druarit e që përfundon rrjeta mrezhë e tutje deri tek arra, kjo pjesë është shfrytëzuar nga A. dhe ara që është ./-0 që 5 vite është punuar herë pas here nga A. por jo me lejen time edhe pse kam kundërshtuar por edhe njëherë ritheksojë se në vitin 2022 unë e kam pasur në posedim.

I padituri A.LL gjatë shqyrtimit kryesor i proceduar në cilësi të palës ka deklaruar: lidhur me çështjen kontestuese përveç dy viteve të fundit unë nuk e di se e ka punuar ndonjëherë ndokush tjetër tokën, pra vetëm unë dhe familja ime e kemi punuar atë tokë, për të cilën kam paguar edhe qera. Asnjëherë nuk kemi pasur problem, përveç tani që dy vite të fundit , ku ka sjellur edhe njerëz të pa njohshëm e që më kanë kërcënuar në pronën time. Duke më thënë se çfarë po bënë ti këtu, kishin qenë me kapela syze të diellit, ku ju kam thënë se ka qenë adet me u prezantu se kush jeni. Gjatë bisedës me ta ka ardhur edhe S., me të cilin kam biseduar edhe unë, dhe kjo ka ndodhur pas shtatorit të vitit të kaluar. Për tokën sigurisht që e kam paguar qiranë rregullisht, kush ta len tokën për 50 vite? Qiranë ja kam paguar S.t. Në ndërkohë S. më ka njoftuar duke më thënë se dua me matë tokën, ku ka qenë viti 2012 ka qenë dimër, në shtator të vitit të kaluar S., e autorizuar e tij dhe gjeodetit Z.I. Z. nuk ka pasur asgjë në dorë, ndërsa unë i kam thënë se duhet të vijnë edhe mixhallarët këtu e të përfshihen të gjithë. Gjatë bisedës me të, S. i ka thënë ndama tash oborrin, e ai i ka thënë se unë kam ardhur i pa përgatitur se ti nuk më ke thënë asgjë. Avokatja i ka thënë hajde se këtu është rrezik, por ky ka vazhduar duke i prerë bagremat duke i gjuajtur degët mbi mollat tona, ky ka mbetur duke i prerë degës e ne sjemi marrë më me të. Për daljen në teren nuk më ka njoftuar askush pasi që unë jam aty 24 orë se kam fermën e bagëtive, eksperti nuk ka thënë asgjë pasi që ka qenë i pa përgatitur. Dy ditë para datës 10 Shtator 2022 apo më shumë që për momentin nuk më kujtohet jemi dakorduar që unë së bashku me vëllain tim M. dhe S. së bashku me vëllain A.1 që të vijë ditën e premtë dhe të bëhet ndarja si të kanë qef. Por këta nuk kanë ardhur në këtë ditë dhe atë ditë kur kanë dal në terren gjeodeti ka thënë se unë nuk jam i përgatitur dhe kjo me qëllim që të bëhet si rast dhe jo që ka pasur ndonjë pengesë që ai ta bëjë matjen. Unë kam deklaruar se më herët është bërë një matje pasi që ne e dimë që e

kemi blerë sipërfaqen prej 50 ari dhe këta me paratë e kësaj sipërfaqe kanë blerë pronë në Pejë. Me paditësin S. nuk kam pasur asnjë mosmarrëveshje përveç atë ditë që ka ardhur me ata njerëz të pa njohur dhe më ka thënë se ti sonte duhet me mi sigurua 180 euro. Me datën 10.09.2022 S. e autorizuar e tij dhe gjeodeti Z, kanë qenë në pjesën time, kah stalla e bagëtive, përafërsisht kah mesi i saj dhe nuk kanë vazhduar tutje, nuk është tentuar të bëhet zbulimi i ndonjë pike dhe për shkak se i njëjti nuk ka qenë i përgatitur nuk është bërë zbulimi i ndonjë pike. Pjesa tjetër prej teli mrezhë e në drejtim të Lindjes më parë është punuar nga unë, ndërsa dy vitet e fundit nuk është punuar nga askush. Një ditë para se me ardh me ata njerëz ka qenë në kafën Of-on për çka edhe i posedojë incizimet dhe i kam thënë eja dhe ndaje qysh dush se jemi familjar, ai më ka thënë se nuk dume nda kurrqysh, po ai që e blen ka me ju nda qysh ti konvenon atij. Kjo është e tepërt, i kam thënë se pa e ndarë nuk mundesh me pru njerëz, për çka tani është hapur rast me qëllim që tani të paraqitet si kanosje.

Dëshmitari Z.I nga fshati K.... Komuna e Istogut në seancën e datës 08.09.2023 ka deklaruar se jam në dijeni lidhur me rastin ku për ta bërë matjen e ngastrës kontestuese kam qenë para 5-6 viteve por nuk jam i sigurt për kohën, kam qenë për identifikim dhe matje. E kam kryer një matje përafërsisht dhe është dashtë pala me ardh me ba kërkesë për ndarjen e asaj pjese sipas kontratës së shitblerjes dhe kërkesa ka qenë vetëm gojore nga ana e paditësit S.L, mirëpo pala prej asaj dite nuk ka ardhur për vazhdimin e procedurës deri në vitin e kaluar, afërsisht mund të jetë ka muaji i tetë i vitit 2022, ka sjellë dokumentacionin e nevojshëm që i është kërkuar, ka qenë që unë ta njoftojë palën për daljen në terren, mirëpo në ndërkohë pala e kundërt ka ardhur tek unë në zyre dhe ka kërkuar që të mos dal në terren, për shkaqe që për mua janë të pa njohura. Me datën 10.09.2022 nuk është ndërmarrë asnjë veprim, pasi që palët nuk kanë mundën me arit marrëveshje në mes tyre, dhe i kam thënë avokates që po shkoj pasi që nuk mundem të punojë pa marrëveshjen e tyre jam kthyer dhe i kam marrë instrumentet, jam kthyer me kerrin tim. Atë ditë kemi ndaluar diku përfundi shtallës, dhe më pastaj ka ardhur pala – i padituri. Nuk e kam njoftuar palën për dalje në terren pasi që nuk e kam pasur për obligim, mirëpo nga përvoja ime duhet të merret pëlqimi i të dy palëve në terren, kërkesa për dalje ka qenë kërkesë gojore nga pala paditëse dhe e kemi ditur se është pronë e tyre, qëllimi ka qenë vetëm identifikimi i asaj prone pastaj të bëhet kërkesa me dokument përkatës. Në rastin konkret nuk ka qenë e nevojshme marrja e ndonjë dokumenti për ngastrën kontestuese, pasi që pala na ka dërguar direkt tek vendi i ngjarjes. Pala në vendin e ngjarjes na ka treguar për pronën e vet por ne kemi vazhduar pasi që nuk kemi bërë matje por vetëm i kam marr dy a tri pika. Dhe ato i kemi mar në fillim në mes dhe në fund. Në rastin kur pala nuk e ka pronën në emër të vet dhe nëse na fton që të bëhet ndarja apo parcelizimi ne nuk mund ta bëjmë. Njëherë nuk kam qenë në dijeni se ajo pronë është shitur apo jo. Në vitin 2022 kërkesa e paditësit ka qenë për ndarjen e parcelës sipas kontratës së shitblerjes të cilën e ka prezantuar në zyrën time, ndërsa para 5 a 6 viteve kam qenë vetëm për identifikimin për më vonë me dal me ba matjen. Në posedim të kujt ka qenë unë nuk e di.

Dëshmitari N.D nga fshati V... Komuna e Istogut, në seancën e datës 08.09.2023 ka deklaruar se lidhur me identifikimin e ngastrave para 5 apo 6 viteve unë nuk isha prezent, se a ka biseduar A. për këtë çështje dhe zgjidhjen e saj, direkt në kadastrë jo por tërthorazi kam dëgjuar. Jam në dijeni për Zonën Kadastrale ku pretendohet çështja dhe atë në ZK Istog, dhe asnjëri nga palët nuk ka parashtruar ndonjë kërkesë tek unë. Se lidhur me këtë pjesë ekziston një mosmarrëveshje

kam dëgjuar në shërbimin kadasatral. A. e njoh si figurë – si bashkë vendas i këtij qyteti, po jo se kam lidhje shoqërore apo ndonjë formë tjetër me të.

Dëshmitari A.M nga fshati I.... P..... në seancën e datës 08.09.2023, lidhur me çështjen kontestuese ka deklaruar se tokën e Z. LL. P. e ka punuar A., edhe atë deri para 1 apo 2 viteve dhe tani është batall. Arrat dhe fidanët janë të vjetra nuk e di saktë se kush i ka mbjellë, ndërsa frytin e arrave e ka marrë edhe A. edhe S.. Trupat i ka pre S. me sa e di ndërsa degët i ka marr A.. Më kujtohet se kjo tokë para 5 – 6 viteve është matur dhe unë nga distanca i kamë parë gjatë kësaj procedure dhe prej kadastrit sa më kujtohet ka qenë Z., ka qenë prezent edhe babi im U. dhe N.Ll.1 Është matur e tërë sipërfaqja, ku prezent ka qenë edhe S.. Jam fqinjë me palët ndërgjyqëse nga pjesa lindore e ngastrës ./., ./.. pra që i bie ./.. Lidhur me posedimin kohëve të fundit toka nuk punohet nga askush dhe jam në dijeni se kohëve të fundit palët janë në mosmarrëveshje në mes vete. Sa e di unë e tërë prona në tërësi është veq e B., shtalla e bagëtive në atë palujtshmëri është e A.. Prej telit ku është vendosur pika kufitare në ngastrat ./.-+0 dhe ./.. janë punuar nga A. por viteve të fundit nuk janë punuar dhe kush e ka në posedim nuk e di dhe plehu i bagëtive i cili është në kënd afër tek arra është vendosur nga A., por nuk e di se nëse dikush ka kaluar andej, më vonë e kam kuptuar se ata e kanë penguar njëri tjetrin për matje, por kam dëgjuar disa fjalë se S. e ka shitur, e që është në pazar me dikë.

Dëshmitarja Z.P e lindur LL., nga P....., ka deklaruar së është në dijeni së kur ka desh që S., ka dashur të cakton kufirin me A. përmes gjeodetit, por me vonë së çka ka ndodhur nuk ka qenë në dijeni, vendi së ku është penguar dhe mënyrën si është penguar nuk ka qenë në dijeni

Gjykata me rastin e vendosjes, e pas administrimit të të gjitha provave prezent në shkresat e lëndës, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 103, 113 par.1 dhe par.2 të të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDTS), dhe nenit 480 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se pretendimet e palës paditëse janë të pabazuara.

Në bazë të nenit 103 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDTS), parashihet se “personi i cili e ushtron pushtetin faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë “. Me nenin 113 par.1 të këtij ligji është paraparë se “ nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës... “, ndërsa në paragrafin 2 të tij ceket se “nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi, mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore“.

Sipas dispozitës së nenit 480, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, shprehimisht parasheh se shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengim posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë, përjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë dhe pandërgjegjshmërinë e posedimit.

Sipas dispozitës së nenit 7, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë provat me

të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa në dispozitën e nenit 319.1, të LPK -së, parashihet se secila palë ndërgjyqës ka për detyrë të provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Gjykata duke vendosur lidhur me kërkesë padinë e paditësit e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 7.1, 319.1, 321, 322 dhe 480, të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesë padia e paditësit është në tërësi e pabazuar për faktin se me provat e administruara, paditësi nuk e ka argumentuar pushtetin e fundit faktik të posedimit për pjesën kontestuese kush, ku, kur dhe në ç' mënyrë e ka kryer aktin e pengimit të pretenduar e që kërkohet në kuptim të dispozitës së nenit 480, të LPK-së, rrjedhimisht gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret nuk janë plotësuar te tri kushtet esenciale për institutin e pengim posedimit e që janë : kushti i parë, sa i përket afatshmërisë akti pretendohet se ka ndodhur me datë 10.09.2022, ndërsa padia është dorëzuar me datë 04.10.2022, pra çka do të thotë së padia është parashtruar brenda afatit ligjore, por nuk janë plotësuar dy kushte të tjera.

Sa i përket pushtetit të fundit faktik, se a e ka pasur paditësi në posedimin-shfrytëzim pjesën ku pretendohet së është kryer akti i pengim posedimit përkatësisht në mezhdën-kufirin kadastral, nuk është provuar as nga dëgjimi i dëshmitarit A.M, i cili ka deklaruar së “lidhur me posedimin kohëve të fundit toka nuk punohet nga askush dhe jam në dijeni se palët kanë pasur mosmarrëveshje në mes tyre”. Po, ashtu, edhe nga dëgjimi i paditësit i cili ka deklaruar së “ pjesa e shtyllës elektike e cila është e druarit e që përfundon rrjeta mrezhë e tutje tek arra, kjo pjesë është shfrytëzuar nga A. dhe ara që është me numër ./.-0 që pesë vite është punuar herë pas here nga A., por jo me lejen time”, edhe me daljen në teren nuk është konstatuar së ajo pjesë ka qenë në posedim të paditësit por në posedim të paditurit.

Po, ashtu, nuk është plotësuar as kushti i tretë që ka të bëjë me kush, ku, kur dhe në ç' mënyrë e ka kryer aktin e pengimit të pretenduar, nga provat e administruara, nga dëgjimi i palëve ndërgjyqëse në cilësi të palëve si dhe nga dëgjimi i dëshmitarit Z.I i cili ka deklaruar se “nuk është ndërmarrë asnjë veprim me datën 10.09.2022” në ditën kur pretendohet të jetë kryer akti i pengim posedimit për shkak se palët nuk kanë mundur që të arrijnë marrëveshje në mes tyre, si dhe nga deklarimi i vet paditësit se në ditën kur pretendohet se ka ndodhur pengim posedimi “kemi shkuar tek shtalla e deri te përfundimi i shtallës” ku “A. na ndaloj, tha nuk bën me mat”.

Në rastin konkret gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, për shkak se për tu dhënë mbrojtja gjyqësore në procedurën e pengimit të posedimit duhet të plotësohet në mënyrë kumulative kushtet dhe atë: që paditësi të ketë pushtetin faktik, respektivisht të jetë poseduese dhe të ekzistojë pengimi i posedimit në mënyrë të dhunshme, apo me kërcënim serioz. Duke shtuar se pengimi i posedimit mund të kryhet në dy mënyra dhe atë: në bazë të shqetësimit dhe marrjes së posedimit, respektivisht privimit në mënyrë të pa drejtë nga posedimi, por edhe në mënyrë verbale me kusht që shqetësimi nga posedimi të jetë serioz, dhe nëse ka ndikuar në shkaktimin e posedimit të drejtës ose kryerjes së të drejtës së posedimit.

Gjykata këtë rast e ka trajtuar relativisht në mënyrë të kujdesshme çështjen e pengimit të posedimit në mënyrë verbale, duke theksuar se pengimi i posedimit mund të kryhet në mënyrë

verbale në atë mënyrë që shkaktuesi i pengimit të posedimit ia vë në dije poseduesit të sendit se do ta sulmojë jetën, trupin ose pasurinë e tij, ose poseduesit ka për t'i sjellë një të keqe shumë të madhe. Në rastin konkret nuk mund të konsiderohet se është kryer akti i pengim posedimit në mënyrë verbale, për shkak nga provat e administruara nuk është provuar se ka pasur kërcënim të natyrës serioze nga ana e të paditurit, nga i cili paditësi nuk e ka ushtruar posedimin e sendit, dhe as të drejtës së vet, përkatësisht së i padituri nuk i ka komunikuar se do t'i sulmojë jetën, trupin, pasurinë apo se do t'i shkaktojë ndonjë të keqe shumë të madhe nëse nuk largohet nga posedimi.

Së pengimi i posedimit në mënyrë verbale është i mundur dhe mbrojtja gjyqësore duhet të ofrohet në qoftë se plotësohet kushti që kërcënimin të jetë seriozë për jetën apo pasurinë e poseduesit të sendit. Sido që të jetë në çdo rast edhe kur pengimi i posedimit kryhet me veprime fizike, por edhe kur kryhet në mënyrë verbale do të konsiderohet pengim i posedimit, në qoftë se poseduesi e ka pasur posedimin e fundit deri në momentin e kryerjes së aktit të posedimit në çfarë do forme dhe akti i pengimit të posedimit ka ndikuar në shqetësimin e pengimit të posedimit apo privimit nga posedimi.

Posedimi si term ka të bëjë me pushtetin faktik mbi send dhe nuk i referohet pushtetit juridik, ndërsa pengimi në posedim ka të bëjë me shqetësimin apo pengimin në shfrytëzimin e pushtetit faktik apo zhveshjes nga pushteti faktik dhe assesi aspektit juridik sepse këtu kemi të bëjmë me natyrën tjetër të kontestit.

Paditësi, nëse i shpreson suksesit në procedure, mund të inicion procedura të tjera sipas rregullave të procedurës jokontestimore apo kontestimore. Por në rastin konkret elementet e përshkruar të të paditurit nuk paraqesin elementet e kryerjes së aktit të pengim posedimit në raport me paditësin.

Sa i përket shpenzimeve gjykata vendosi duke iu referuar dispozitës së nenit 463.1 dhe 463.2 të LPK – së.

Bazuar në nenet, 103, 113 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat Sendore, nenit 480 të LPK-së, lidhur me nenin 142.3 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA NË ISTOG
Departamenti i përgjithshëm -Divizioni Civil C.nr. 534/22, me datë: 24.05.2024

G j y q t a r i
Shemsedin Haxhiaj

Udhëzim juridik :

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 dite, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2022:203325
Datë: 10.06.2024
Numri i dokumentit: 05802119